Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL
Mbajtur më 03 korrik 2026, i mbledhjes se jashtëzakonshme
Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:10
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.
Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: z. **Enver Rama**,përfaqësues i Komunitetit Rom; znj.**Naime Podvorica**, zyrtare për Barazi Gjinore; z.**Avni Fetahu**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.**Nazif Sheqa**, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit – Podujevë;z.**Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Kërpimeh; z.**Naim Bajrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Orllan z.**Bahri Selimi**, përfaqësues i Emergjencave Civile ; z.**Liman Zeqiri**, përfaqësues i Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim; znj.**Sabrie Bislimi**, përfaqësuese e OJQ-ve; z.**Granit Thaqi**, përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.**Rozafat Maloku**, përfaqësues i Mediave Lokale; z.**Afrim Fazlija**, përfaqësues i Komunitetit të Biznesit dhe z.**Idriz Hoxha**, përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ndërkaq munguan: **z.Bashkim Bajrami**,Komandant i Stacionit të Policisë; z.**Mensur Hoti**, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë lslame; z.**Gjergj Uka**, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z. **Fitim Sejdiu**, përfaqësues i Komunitetit Ashkali; z. **Ymerdin Hasani,** përfaqësues i FSK-së; znj.**Sevdije Mustafa**, përfaqësuese e Komunitetit Egjiptian.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: znj. Valbona Blakçori Zëvendës Komandante e Stacionit të Policisë Podujevë, në vend të komandantit Bashkim Bajrami; Përfaqësuesi i FSK-së z. Arlind Sahiti, në zëvendësim të z. Ymerdin Hasani dhe Përfaqësuesit e KFOR-it LMT z. Peter Molnar.

Rendi i Ditës
Gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës
Rendi i ditës u miratua njëzëri.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke parë prej listës së nënshkrimeve konstatoj se kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë me punë të KKSB. E para ju kërkoj shumë falje ndoshta për kohën e shkurtër të thirrjes së kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, por arsyeja e thirrjes është fakti që patëm një javë jo shumë të lehtë në Komunën tonë, rasti i ndodhjes në Liqenin e Batllavës dhe në veçanti rasti i ditës së djeshme që na tronditi të gjithëve si qytetarë por edhe si institucione. Dhëntë Zoti që të gjithë ata që kanë pësuar në atë rast të kurohen sa më shpejtë dhe raste të tilla të mos përsëriten në Komunën tonë. Ç'është e vërteta ne kemi pas një gjendje stabile, deri më këto raste dhe mendoj që është momenti i përshtatshëm që të marrim ndonjë informatë prej Policisë së Kosovës në radhë të parë, nga përfaqësuesi i FSK, por sigurisht edhe nga përfaqësuesi i KFOR-it. Pa humbur kohë fjalën ia kaloj Zëvendës Komandantes së Stacionit Policor znj. Valbona Blakçori, e cila është e pranishme, në mungesë të Komandantit të Stacionit të Policisë z. Bashkim Bajrami, që të na jep një informatë të shkurtër për atë çka ka ndodhë tërë javën por në veçanti për këto dy rastet e fundit, ku fatkeqësisht njëri ishte fatal para disa ditësh në

Liqenin e Batllavës dhe rastin e djeshëm që ishte rast i rëndë në qendër të qytetit, ku përveç atyre akterëve të cilët faktikisht ishin të përfshirë drejtpërsëdrejti, u rrezikua edhe jeta e qytetarëve ku në ato momente ishin në sheshin e qytetit të Podujevës.

znj. Valbona Blakçori, Zëvendës Komandantes së Stacionit Policor, theksoi, fillimisht ju informoj se Komandanti i Stacionit të Policisë është në pushim vjetor dhe gjendet jashtë vendit dhe pikërisht për këtë arsye më ka autorizuar mua që të jem në këtë takim. Dita e djeshme ka qenë një situatë jashtëzakonisht e rëndë për ne si institucion, por edhe në përgjithësi dhe besoj se jemi munduar ta trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Do të jem shumë transparente dhe do të ju informoj rreth të gjitha veprimeve që kemi ndërmarrë dhe që ka ndodhur lidhur me rastet. Kërkoj falje nëse ka shumë pyetje mirëpo për shkak të ndjeshmërisë së rastit nuk kisha hyrë shumë në detaje, por do të raportojë ato të cilat janë më të rëndësishmet për ju dhe për qytetarët, realisht ato për të cilat jeni të informuar edhe përmes mediave elektronike dhe të tjera. Ju informojë që më datë 02.07.2026 rreth orës 13:40 është raportua rasti i të shtënave me armë. Policia menjëherë i është përgjigjur thirrjes dhe ka konstatuar se në këtë rast janë të përfshira dy familje Zejnullahu dhe Xhemaili. Në vendin e ngjarjes kanë mbetur të plagosur tre persona; Agim Xhemaili, Fidaim Zejnullahu dhe Fatlum Zejnullahu, ndërsa më vonë është raportuar se nga të shtënat me armë ka pësuar edhe një kalimtar i rastit, por për shkak të hetimeve të rastit nuk po përmendi emrin e tij. Në vend ngjarje kanë dalë njësitë interevenuese dhe u është ofruar ndihma e parë të lënduarve deri sa ka arritur autoambulanca e emergjencës dhe më pas është bërë edhe sigurimi i vendit të ngjarjes. Të lënduarit janë marrë nga Njësiti i emergjencës dhe pastaj janë dërguar në Emergjencën e qytetit dhe më pas për trajtim në QKUK Prishtinë, në përcjellje të Policisë. Në vend të ngjarjes janë sekuestruar tri armë zjarri dhe aty ka qëndruar edhe prokurori i shtetit dhe njësitë tjera të specializuara të Policisë së Kosovës gjegjësisht të Departamentit për trajtimin e rasteve të rënda. Në vazhdimësi të trajtimit të rastit janë kontrolluar dy shtëpitë e familjeve të involvuara ku janë gjetur armë dhe municion i konsiderueshëm. Për të gjitha këto në koordinim me prokurorin e shtetit janë evidentuar rastet penale ashtu siç i parasheh Kodi penal i Kosovës. Motivet e rastit akoma nuk dihen për shkak se personat e involvuar ende janë në trajtim shëndetësor dhe përderisa ata nuk deklarojnë se për çfarë ka qenë mosmarrëveshja neve nuk mund të aludojmë apo supozojmë për motivin. Këto janë informatat preliminare. Nëse dikujt në ndërkohë i intereson diçka më shumë mund të jap edhe informata të tjera. Rastet e tilla me të vërtetë janë shqetësuese, mirëpo nuk duhet konsideruar si cenim të sigurisë së përgjithshme, sepse këto janë raste të izoluara, raste mes këtyre familjeve. Nganjëherë policia nuk mund të ketë qasje te familjet. Mirëpo kjo duhet të jetë indikacion se ne të gjithë duhet të kontribuojmë në krijimin e ambientit të sigurisë duke bashkëpunuar qytetarë me polici dhe duke shkëmbyer informata, pikërisht aty ku familjet kanë mosmarrëveshje mes veti, sepse sikurse e ceka në shumë raste Policia është e pa qasshme në identifikimin e tyre, për shkak të izolimit, po i quaj të tyre të brendshëm. Familjet në fjalë nuk kanë pas asnjëherë raste të raportuara për problemet mes veti. Sikur të kishim informata do ta kishim trajtuar atë sikur se çdo rast tjetër, sepse kemi sektor të veçantë policor që merren pikërisht me problematikat apo mosmarrëveshjet, mirëpo ne nuk kemi pas asnjë indikacion se këto familje në lidhje familjare nip-dajë kanë mosmarrëveshje mes veti. Në kontekst të kësaj dhe jo vetëm Stacioni Policor në Podujevë ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë për të krijuar ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë rezidentët e Komunës tonë. Falë angazhimit të Policisë është arrite të parandalohet ndoshta një vrasje e trefishtë. Gjatë sezonit të verës dhe jo vetëm kemi zyrtarë policorë edhe në uniformë dhe në rroba civile në shesh të qytetit dhe pikërisht kjo ka ndodhë kur zyrtari policor ka korrespondua në një distancë rreth 80-100 m gjatë patrullimit dhe ka ndërhyrë duke e neutralizuar personin që ishte i përfshirë në këtë rast me armë në dorë. Ne nuk duhet të lavdërohemi apo të kërkojmë falënderime prej askujt sepse është një detyrë dhe .përgjegjësi për çka ne kemi dhënë betimin dhe jemi përgjegjës për të krijuar rend dhe siguri, mirëpo angazhimi ynë ka arrit që të parandalohet një vrasje e trefishtë. Ndërsa sa i përket rastit në Liqenin e Batllavës po ju informojë në pika të shkurtra, edhe pse këtu edhe FSK mund të jap informacione për punën që kanë bërë. Unë po raportoj rreth asaj që është raportuar

dhe veprimet e koordinimet ndërinstitucionale që i kemi pas. Pra më datë 30.06.2026 rreth orës 13:35 kemi pranuar informatë se një person i gjinisë mashkullore kishte rënë nga barka në Liqenin e Batllavës dhe nuk kishte dal. Kjo ishte informata preliminare dhe ishte dhënë nga shoqëruesja e viktimës. Njësitë policore menjëherë i janë përgjigjur thirrjes dhe kanë siguruar të dhënat e viktimës i cili ishte Lirim Ruhani i moshës 25 vjeçare, po e citoj sepse emri i tij ka qarkulluar përmes mediave. Ne menjëherë kemi informuar edhe njësitë tjera relevante të kërkim shpëtimit, në këtë rast edhe pjesëtarët e FSK-së. Unë shprehu mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë drejtim. Më datë 01.07.2026 në ora 12.48 ishte gjetur trupi i viktimës dhe i njëjti është identifikuar nga familjarët e tij dhe pas konstatimit të vdekjes nga ekipi i emergjencës shëndetësore trupi është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion dhe pas procedurave përfundimtare nga ana e tyre trupi është liruar dhe dorëzuar familjarëve. Kjo ishte një përshkrim i ngjarjeve në formë të shkruar. Rasti i fundit është në fazën e hetimeve dhe është cilësuar si vrasje e rëndë në tentativë, cilësuar si asgjësim apo dëmtim i pasurisë, sepse njëri nga lokalet aty kishte pësuar edhe dëmtime, si dhe armëmbajtje apo posedim i paautorizuar i armëve. Këto ishin çfarë kisha për të thënë rreth rasteve të fundit. Nëse ka ndonjë pyetje jam në dispozicion për ofrimin e përgjigjeve, për çështjet që kam informacion dhe kam kompetencë të japi informata sepse rasti është në fazën e hetimeve.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderojmë Zëvendës Komandanten e Stacionit policor për informatat, ndërsa fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të FSK-së.

z.Arlind Sahiti, përfaqësues i FSK-së , theksoi, fillimisht në emër të FSK-së kisha dashtë të shpreh keqardhjen për rastet që ndodhën brenda një periudhe shumë të shkurtër. Sipas vlerësimeve tona që i bëjmë në aspektin e sigurisë, Komuna e Podujevës ka qenë një prej atyre e cila qëndron mirë për shkak se nuk ka pas ngjarje të karakterit të tillë. Sa i përket rastit të ditës së djeshme shumë pak mund të flasim sepse është kompetencë e Policisë së Kosovës. Unë kisha dashtë ti përgëzojë Zëvendës Komandanten dhe pjesëtarët e Policisë për reagimin e tyre. Rasti ishte i rëndë dhe po të mos ishte reagimi në kohë i zyrtarit policor tashmë do të ishim duke folur për një ngjarje ende më të rëndë. Ndërsa sa i përket ngjarjes në Liqenin e Batllavës vlerësoj se koordinimi institucional me Policinë dhe institucionet relevante ka qenë shumë i mirë. Me marrjen e njoftimit për zhdukjen e një personi në Liqenin e Batllavës, njësitë tona me kapacitet njerëzore dhe materiale të kërkim shpëtimit kanë dal në terren dhe kanë bërë kërkimin e trupit të pajetë. Ditën e nesërme është gjetur trupi. Njësitë tona kanë bërë në mënyrën më të shpejtë dislokimin duke pas parasysh distancën e Njësisë së Kërkim Shpëtimit me Komunën e Podujevës Referuar rastit në fjalë, kisha dashur nëse ka mundësi që të ketë më shumë patrullime nga ana e Policisë, lidhur me këtë do të pyesja Zëvendës Komandanten cilat janë mundësitë në këtë aspekt, ose fjala vjen të ndërmerret ndonjë masë me efekt parandalues për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, në mënyrë që rastet e tilla të mos na përsëriten.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderojmë përfaqësuesin e FSK-së, në vazhdim fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it.

z. Peter Molnar, përfaqësues i KFOR-it LMT, theksoi, faleminderit z. Kryetar që na dhe fjalën. Lidhur me rastin e djeshëm kemi qenë të shqetësuar kur morëm lajmin sepse Komuna e Podujevës është Komunë shumë e qetë. Sa i përket kësaj çështjeje ne kemi informuar instancat tona të larta të KFOR-it dhe presim përgjigje nga to se çka ne duhet me ndërmarrë lidhur me këto raste, por pa marr parasysh ne do të përforcojmë dhe do të rrisim numrin e patrullimeve këmbë sa i përket qendrës së qytetit, por edhe sa i përket patrullimeve mobile rreth qytetit. Këto janë për momentin hapat që si KFOR mund t'i ndërmarrim, por për hapa tjerë presim urdhra prej instancave më të larta.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderojmë përfaqësuesin e KFOR-it për informatën. Theksoi, e hap diskutimin rreth kësaj pike.

z. Naim Bajrami, theksoi, unë vij nga një rajon që bën pjesë edhe si zonë kufitare, por Orllani me fshatrat përreth është edhe si zonë turistike. Mirënjohje për Policinë e Kosovës dhe FSK-në. Rasti i mbytjes së të riut në Liqenin e Batllavës më datë 30.06.2026 na ka prekur të gjithëve,

sepse Podujeva ka qenë si zonë e qetë. Pse them mirënjohje për Policinë e Kosovës por edhe për Komunën, sepse po atë ditë me Kryetarin e Komunës dhe Policinë kemi dal në vendin e ngjarjes, ,kemi shkuar në shkollë dhe kemi hap kamerat por vendi ku kishte ndodhur rasti ishte larg nga shkolla. Unë në cilësinë e kryetarit të KLSP në Orllan kam kërkuar nga Policia e Kosovës Stacioni i Podujevës të bëjnë një kërkesë në MPB që duke filluar nga penda e Liqenit e deri në fshatin Orllan të instalohen më shumë kamera sepse me ndodhjen e rastit jam bindur për rëndësinë që kanë kamerat për sigurinë e qytetarëve. Orllani gjatë kohës së sezonit veror si zonë turistike që është frekuentohet me vizitorë të shumtë, ndoshta gjatë ditëve të vikendit mund të ketë deri 10000 vizitor, e mos të flasim për tërë sezonin. Duhet së paku 4-5 kamera më shumë dhe të gjithë vizitorëve së paku tu identifikohen tabelat e veturave. Ishte e pranueshme kërkesa e përfaqësuesit të FSK-së për monitorime më të shpeshta të policisë së Kosovës në atë pjesë.

z. Granit Thaçi, sa i përket rastit të djeshëm, dua të theksoj se unë punoj 20m larg vendit ku ndodhi ngjarja dhe zyrtari policor me intervenimin parandaloi një tragjedi shumë më të madhe. Mirëpo kur ndodhin këto incidente ne duhet parë se çfarë mund të bëjmë për të përmirësuar apo në cilat pjesë duhet ndërhyrë. Nga ajo që pash dje dhe nga analizat që i kam bërë më pas por edhe nga mediat dhe qytetarët nuk jam në dijeni se a ndërlidhen veç me policinë apo edhe me Komunën, si pyetje e parë, cili është roli i kamerave të sigurisë së qytetit, a kanë të gjitha pamje të pastër, sepse para dy jave del që një reklamë, ndoshta me leje apo pa leje, vendoset 30 cm larg kamere, është rasti te Interexi, e cila ka qenë edhe në media kjo. Nuk jam në dijeni se kush e menaxhon këtë situatë. Cili është roli i kamerës për Policinë dhe a i ka të gjitha kamerat e vendosura aktive dhe me pamje të pastër, ndërsa pyetja e dytë, unë jam në dijeni se reagimi i policisë ka qenë shumë i shpejtë, ndërsa i tri ambulancave ka qenë 10 min prej krismës së parë në Shesh, e që për mendimin tim intervenimi ka qenë shumë i shpejtë në atë ngjarje të rëndë. Mirëpo pyetja është se cili është roli dhe kush i menaxhon pengesat në hyrje të Sheshit, te lokali Pranvera, sepse për shkak të pengesave i pamë autoambulancat duke shfrytëzuar rrugë anësore me ndihmën e qytetarëve për të hyrë në Shesh dhe koha është me rëndësi dhe ndodh që për një minutë bëhet shumë vonë, këto mendoj se më shumë janë për Policinë, ndërsa për Komunën janë nëse ka ndonjë pengesë për ta evituar.

znj. Valbona Blakçori, Zëvendës Komandantes së Stacionit Policor, theksoi, faleminderit për pyetjen dhe vlerësoj shumë at që theksuat për policinë në kuptimin e reagimit të shpejtë dhe profesional. Sa i përket pyetjes për kamera të sigurisë , i referohem asaj çka është kompetencë e jona. Sigurisht jeni në dijeni se përkohësisht jemi vendos në ish objektin e Kuvendit komunal, për shkak të renovimit të objektit të Stacionit të Policisë dhe kamerat e sigurisë të qytetit për momentin janë jofunksionale për arsye siç theksova Stacioni i Policisë në Podujevë është duke u rinovuar dhe kamerat janë jo funksionale derisa ne të kthehemi në objektin e Stacionit të Policisë. Edhe dje ne jemi orientuar në mbledhjen e dëshmive të kamerave të bizneseve të ndryshme. Pra kamerat tona të sigurisë nuk kemi pas mundësi ti monitorojmë dhe nuk kontrollohen për shkak të renovimit të objektit të Stacionit të Policisë, i cili do të përfundoj në dhjetor 2026. Sa i përket pjesës së autoambulancave kjo është përgjegjësi e nivelit komunal por për hir të korrektësisë dhe informimit për të gjithë ju unë i referohem dokumenteve zyrtare dhe jo asaj se çka flitet në opinionin publik. Në bazë të dokumenteve zyrtare të policisë së Kosovës autoambulanca në vendin e ngjarjes ka arritur fiks për 7 min, që nëse bëjmë një analizë nga vendi i ngjarjes dhe vendin ku gjendet autoambulanca, nuk besoj se do të kishte reagim më të shpejtë, sepse marrë parasysh kur ka ndodhë rasti është koha e frekuentimit më të madhe të qytetarëve dhe automjeteve si në rrugë ashtu edhe ne shesh, kështu që mendoj se ka qenë një reagim shumë i shpejtë dhe profesional nga ana e tyre, ndërsa te pjesa e barrierave mendoj se Komuna ka përgjigje për këtë. Sa i përket pyetjes së z. Naim Bajrami për vendosje të kamerave të sigurisë ne këtë çështje e kemi trajtuar edhe në nivel të Drejtorisë Rajonale mirëpo ende nuk kemi marrë një përgjigje sepse është një çështje që kërkon trajtim më shumë se kush është përgjegjës për monitorimin e Liqenit të Batllavës, e pastaj ajo pjesa e vendosjes së kamerave. Me marrjen e përgjigjes ju si anëtar të Këshill do të jeni të parët që informoheni.

Sa i përket kërkesës së zyrtarit të FSK-së për shtimin e patrullimeve përgjatë Liqenit të Batllavës, ju sigurisht jeni në dijeni se atje ne kemi njësi patrulluese 24/7 që vazhdimisht patrullojnë në atë lokacion, mirëpo për neve sfiduese është lundrimi i barkave në Liqenin e Batllavës, pra ne furnizohemi me ujë të pijshëm nga Liqeni, ndërsa bazuar në ligjet me të cilat ne punojmë si Polici nuk kemi bazë ligjore që të marrim masa ndaj tyre, mirëpo duhet të ekzistoj një rregullore ndoshta edhe nga ana e Kuvendit komunal që të bëjë ndalimin e lundrimit të këtyre barkave qoftë me motor apo pa motor. Pastaj edhe noti në Liqenin e Batllavës, ndikon në ndotjen e ujit, edhe pse shkon nëpër pastrime dhe filtra deri sa të vjen tek ne, mirëpo me të vërtetë është e papranueshme. Unë e di që është zonë turistike por sikur të kishim mundur ne si KKSB me dal me një rregullore apo propozim apo çfarëdo qoftë me bërë ndalimin e këtyre që theksova, përndryshe policia do të ketë pak telashe, përveç nëse koordinohemi me Policinë Kufitare, të cilat janë njësi më të avancuara dhe kanë pajisje të ndryshme logjistike që do të mund të na mbulonin. Për shkak të angazhimeve të shumta dhe kapacitete njerëzore të pakta është pamundur që të kemi patrullime të vazhdueshme në Liqenin e Batllavës, sikurse e ceku njëri nga përfaqësuesit këtu. Nuk e di sa do të kishim mundur të punojmë në këtë drejtim të punojmë për ndalimin e këtyre që theksova, sepse thuajse çdo vit kemi persona që mbyten në Liqenin e Batllavës.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, në vazhdën e kësaj që theksoi Zëvendës Komandantja e Stacionit të Policisë dhe për pyetjen e Granit Thaçit, ju informoj që çelësat e atyre pengesave që ngritën në hyrje të Sheshit janë në pjesën e hyrjes së Komunës këtu dhe janë 24 orë në funksion për të dyja pjesët e hyrjes në Sheshin e Qytetit dhe për këtë çështje kanë qenë të informuar Policia, zjarrfikësit dhe urgjenca në rast nevoje. Si kanë depërtuar autoambulancat nuk jam në dijeni se skam informata por ajo që e di është se nuk janë kërkuar çelësat dhe s'ka ardhur askush për ti marr. Ata çelësa vazhdojnë të jenë këtu. Unë sot kërkova prej zyrtarëve kompetent për të gjetur një solucion tjetër për ata çelësa dhe vendqëndrimin e atyre çelësave. Ishte njëra prej ideve t'i bëjmë disa kuti të sigurta dhe ti vendosim në lokacion të hapësirës së Sheshit dhe ti mbyllim me një kod të caktuar dhe ai kod të jet te Policia, KFOR-i , FSK-ja por normal edhe te ne si autoritet komunal. Unë që dje u interesova për këtë çështje dhe çelësat janë duke qëndruar te portiri i Komunës dhe këtu do të jenë deri sa nuk bëjmë zgjidhje. Por e diskutuam sot që ndoshta duhet të vendosen te Galeria atje në hyrje, në një kuti ku do të jenë të sigurt, dhe tjetrin aty ku është e nevojshme, pastaj kodin e hapjes dhe përdorimit /të tyre do ua dërgojmë organeve kompetente, ku do ta kenë në dispozicion që në rast nevoje për uljen e barrierave. Ju e dini që atje e kemi bërë një pengesë që ndoshta nuk është shumë e qëlluar por e kemi bërë për shkak të këtyre taksive ilegale për shkak të pengesave të mëdha që po shkaktojnë në hyrje të asaj pjese dhe besoj se nga nesër do të marrim edhe një veprim tjetër ti largojmë domosdoshmërisht ato pengesa nga aty dhe do të shohim se çfarë mund të bëjmë për të mos rikthyer ato pengesa shkaku i taksive ilegale të cilat po shkaktojnë çrregullim në atë pjesë të trafikut. E rëndësishme është që nuk ka pas vonesë dje të tri intervenimeve të urgjencës për arsye të atyre pengesave sepse koha është reale për ofrimin e shërbimeve për ata që kanë pas dje nevojë, por sigurisht se duhet të jemi më të përgatitur për situata të tilla, sepse vërehen disa lëshime në kuptimin teknik. E dyta, sa i përket kamerave të sigurisë, Komuna e furnizon qytetin me kamera komplet dhe me mirëmbajtje të tyre. Për numrin e kamerave nuk kam informatë të saktë, por e di që çdo udhëkryq i qytetit të Podujevës është i mbuluar me kamera dhe nëse nuk gaboj, njëra prej kamerave ku del ai dushku para mendoj se është i kamerave tona në Shesh, se a janë duke u monitoruar apo jo nuk jam në dijeni sepse nuk e kam këtë informatë unë dhe nuk është kompetencë e Komunës monitorimi i kamerave të qytetit, por këtë të drejtë e ka vetëm policia e Kosovës. Prej atyre shumë postimeve që dolën vërejta se njëri prej atyre gjetheve që pengonte ishte e njërës prej kamerave në afërsi të bustit të Dëshmorëve të Kombit në qendër. Besoj në kuptimin e monitorimit dhe pamjes së asaj gjendjeje nuk është ndonjë telashe sepse të gjitha dyqanet aty kanë kamerat dhe besoj se policia së bashku me prokurorinë ka kryer punën. Por duhet ndërmarrë edhe masa tjera, fjala vjen dikush është dashtë të tërheq vërejtjen për largimin e dushkut i cili i dilte para kamerës tonë, një rast i tillë ka qenë kur është vendos tabela dhe ka mbuluar pamjen e

kamerës, sikurse e thekoi z. Granit Thaçi, aty është intervenuar menjëherë ditën e nesërme dhe është larguar ajo reklamë. Përndryshe mund të themi se qyteti nuk është keq në kuptimin e mbulueshmërisë me kamera, mund të ketë ndonjë defekt të kohëpaskohshëm me të cilin komunikojmë rregullisht me policinë, sepse varësisht nga kërkesat e tyre veprojmë ne si institucione. Ne për çdo vit kemi kontrata të reja për mirëmbajtje por edhe për furnizim me kamera të reja. Para disa jave kemi pas një takim edhe e anglezët të cilët na kanë premtuar një sistem më të avancuar dhe jemi në pritje. E përsëris se në kuptim të mbulueshmërisë së qytetit qëndrojmë mirë, çdo cep i qytetit është i mbuluar me kamera. kështu që Policia deri sa të kalojnë në objektin e tyre pas renovimit nuk i kanë në qasje në aspektin teknik por realisht kamerat janë funksionale dhe aktive, edhe pse për momentin nuk jemi në monitorim.

znj. Valbona Blakçori, Zëvendës Komandantes së Stacionit Policor, theksoi, u keqkuptova sepse kamerat janë ashtu sikurse janë vendosur dhe kanë mbulueshmëri por thash se nuk janë funksionale 24 orë aspektin e monitorimit nga ana e zyrtarëve policor për shkak se jemi të zhvendosur në objektin e ish Kuvendit Komunal.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, pra kamerat janë funksionale dhe aktive dhe mund te jene ne dispozicion dhe te shfrytëzohen nëse paraqitet nevoja edhe pse aktualisht nuk janë të qasshme nga ana e zyrtareve policor për arsyet që veç se u theksuan nga Zëvendës komandantja e Stacionit Policor. Ndërsa sa i përket rregullores për barkat me motor, ju e dini që Liqeni i Batllavës por edhe zona përreth është zonë e mbrojtur, për këtë është vendimi për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat e tyre mbrojtëse te burimit ujor sipërfaqësor – Akumulimi i Batllavës, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2013. Me atë vendim por edhe rregulloret të cilat ekzistojnë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është e ndaluar lëvizja e barkave me motor në Liqenin e Batllavës, përveç barkave sportive. Prandaj çdo hasje e dukurive të tilla të barkave me motor është mundësia e shqiptimit të gjobave dhe dënimeve përkatëse nga forcat e rendit, pastaj e Shoqatës së Peshkatarisë sepse edhe ata kanë obligim të monitorojnë dhe të mbajnë kontaktet me organet e rendit. Çdo zonë e mbrojtur nënkupton se ndalohet qarkullimi i barkave me motor dhe vendimi përmban edhe masat shtesë që merren dhe që duhet të merren për arsye se është në pyetje uji i pijes, prandaj ne në çdo rast dhe çdo kohë kemi bazë të mjaftueshme të mbështetemi. Mendoj se është kundërvajtje qarkullimi i barkave me motor dhe i njëjti mund ti konfiskohet nga autoriteti përgjegjës dhe të hapen procedura tjetra përkatëse. Këto masa dhe veprime mund të bëhen me një koordinim pak më të mirë. Çështja tjetër te Liqeni i mbulueshmërisë me kamera, aty kemi diku rreth 8 km dhe në shumë hapësira mund të jetë problematike edhe veprimi i qasjes sepse ju e dini se çfarë konfiguracioni ka dhe duhet ditur se ku duhet vendosur kamerat. Në rrugë mund të vendosen por qëllimi është te uji sepse uji është rreziku dhe aty është problem vendosja.

Ne mund ta diskutojmë vetëm një problem, a duhet lënë ato barka sportive të vazhdojnë aktivitetin e tyre a jo, por të gjitha vdekjet në Liqen nuk janë nga barkat sportive, por sipas informacioneve shumica që kanë hyrë të lahen ju ka ndodh ngulfatja dhe fundosja. Prandaj nëse e vlerësojmë se këto barka mund të shkaktojnë rreziqe ne kemi mundësinë dhe potencialin që të shkojmë përmes inspektoriatit sepse mendoj se edhe ashtu nuk kanë ndonjë bazë legale, krejt ilegale janë. Nëse vlerësojmë për të rritur masat e sigurisë për ato barka, nuk lejohet asnjë person në barkë pa jelekun shpëtues. Sikur të kishte jelekun shpëtues viktima në Liqenin e Batllavës, ndoshta do të kishte shpëtuar. Gjithashtu jeni në dijeni se aty ka të vendosura tabela me të cilat ndalohet larja në Liqen dhe pa një rregulllativë ligjore ajo nuk është ndaluar dhe brenda ditës sikurse jeni në dijeni janë zhdukur ato tabela. Bazë ligjore për të vepruar aty kemi. Nëse ne si KKSB vlerësojmë se ato barka janë rrezik , ne i marrim veprimet dhe i ndalojmë. Ato nuk e ndotin ujin por janë për atraksion, për rekreacion, mirëpo nëse vlerësohet se domosdoshmërish duhet bërë këtë, duke i detyruar që çdonjëra prej barkave duhet të jetë e pajisur me jelekë varësisht prej numrit të personave dhe nëse një barkë haset në ujë pa jelekë të e sigurisë, atëherë duhet shtuar monitorimin atje nga policia edhe inspektoriati ynë. Por edhe për të bërë atë monitorim ne duhet furnizuar me mjete dhe pajisje të mjaftueshme në mënyrë që mund të kryejnë

veprimin, ose për të shqyrtuar mundësinë edhe gjatë tërë kohës të qëndrojë permanent atje, mirëpo 8 km gjatësi është e pamundur të mbulohet me një zhytës, sepse nuk ka kurrfarë mundësie fizike për të mbuluar tërë Liqenin e Batllavës me një zhytës. Këto janë gjëra që është mirë t'i diskutojmë, ato që lidhen me problematikën në kuadër të fushëveprimit të institucioneve tona lokale domosdoshmërisht jemi të gatshëm të marrim masat dhe veprimet dhe ti kryejmë punët tona, ndërsa pjesa tjetër që lidhet me sigurinë edhe ashtu kërkohet bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, e nëse ka nevojë edhe me instanca tjera pse jo për të diskutuar. Unë desha të zhvillojmë debat për mangësitë dhe problemet, sepse puna që është bërë prej FSK-së atje në hulumtimin për gjetjen e trupit të pajetë është diçka e jashtëzakonshme dhe sigurisht meriton falënderim të veçantë. Unë isha vetë prezent atje ditën e parë kur ndodhi rasti dhe pash se sa janë të gatshëm për kryerjen e detyrave në mënyrën më të mirë. Gjithashtu dje pamë shembullin konkret të zyrtarit policor i cili në fakt e rrezikoi jetën e vet për të parandaluar diçka më të keqe që ka mundur të ndodhë, dhe këto janë raste që duhet në çdo mënyrë apo formë për t'i falënderuar, sepse jo gjithkush do të bënte veprimin e zyrtarit policor, veprim trimëror për të parandaluar për mos ardhur deri te më e keqja. Prandaj këto janë raste të veçanta që duhet falënderuar dhe sigurisht që i falënderojmë. Është shumë mirë që kemi pjesëtar të tillë të përgatitur mirë çoftë nga Policia e Kosovës dhe nga FSK dhe sigurisht që ne si institucione lokale dhe ato qendrore me qenë të gatshëm për tu ofruar ndihmë kujtdo që është e nevojshme dhe që varet nga ne dhe që ka nevojë. Prandaj edhe pjesëtarët e FSK-së dhe zyrtarin policor, urgjencën dhe të tjerët të përfshirë në parandalimin dhe dhënien e ndihmës së parë dhe veprimet e shpejta që janë bërë meritojnë falënderim të veçantë sepse mendoj se reagimi i Policisë së Kosovës dhe i FSK-së Urgjencës ka qenë shumë i shpejtë dhe i gjithë atyre instancave që kanë qenë në moment të duhur dhe vend të duhur dhe kjo ka parandaluar që ai incident të shkoj me pasoja shumë më të mëdha. Nuk është që nuk ka pas pasoja, sepse pasojat po i shohim, katër qytetarë të lënduar dhe kur e llogaritim se çfarë ka mund të ndodhë me tërë atë potencial të armëve që janë kanë në dispozicion të atyre të involvuar, pasojat kishin mund të jenë shumë më të mëdha. Ndërsa rasti i mbytjes në Liqenin e Batllavës, është rast më i izoluar, më i papritur, sepse po shohim që kemi frekuentim të madhe të qytetarëve në atë pjesë, veçanërisht gjatë periudhës së verës dhe duhet të ndalemi të gjithë bashkë të analizojmë ku janë lëshimet dhe çka mund të përmirësojmë dhe nëse kemi ndonjë element që mund të jetë burim i rrezikimit të jetës së qytetarëve atëherë duhet marrë masat dhe duhet ti ndalojmë. Në liqen shumë veprime që janë duke u bërë janë të ndaluara legalisht sepse bëhet fjalë për ujë të pijes, por që qytetarët është bukur vështirë për ti ndaluar sepse për vite e vite të tëra po e shfrytëzojnë atë resurs gjatë verës për freskim dhe është bukur problematike kjo çështje.

z. Granit Thaçi, theksoi, sa për informim te zona e Batllavës dhe e Orllanit, mendoj se për atë zonë para se me fole për pjesë specifike qoftë edhe të sigurisë dhe e përdorimit, unë sjam informuar sepse është viti i parë në këtë formacion të Komunës por paraprakisht duhet ditur si e mendon Komuna Batllavën dhe Orllanin në dhjetë vitet e ardhshme, a e mendon si zonë që duhet mbajtur si sterile të pa përdorur apo si potencial turistik e ekonomik. Në bazë të kësaj si e mendon Komuna këtë zonë në strategjinë e saj atëherë edhe duhet shtruar diskutimin.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi Komuna nuk ka çka mendon këtu, sepse nuk është në pyetje mendimi i Komunës. Kisha preferuar që në këtë diskutim tonin, i cili është edhe qëllimi i thirrjes së kësaj mbledhjeje të kemi çështjen e sigurisë, janë vendimet e instancave më të larta që janë marr për atë objekt ujor dhe Komuna vetëm duhet ti zbatojë ato vendime të nivelit qendror. Ndoshta në aspektin e valorizimit është një moment tjetër që mund të diskutojmë pak më gjatë, sepse nuk mendoj se është momentum i përshtatshëm për të hyrë në këtë diskutim.

z. Avni Fetahu, theksoi, shpreh keqardhje për të dyja rastet që ndodhën në Komunën tonë dhe njëkohësisht falënderime për punë të shkëlqyer dhe profesionale të institucioneve. Kryetar, kisha kërkuar, ndoshta do të ishte mirë me dalë me ndonjë propozim vendim, atë që e theksuat te çështja e barkave që janë pa motor. Në tërë botën e ke që personat që vendosen në barka secili ka jelekët mbrojtës por edhe disa goma specifike në vet barkën për sigurim nga zhytja. Pra me marr

një vendim që inspeksioni së bashku me Policinë ti monitorojnë, sepse sikurse e theksuat ndoshta një jelek shpëtues do ti kishte shpëtuar jetën të përmendurit, ose kujtdo tjetër në të ardhmen.

z. Afrim Fazlija, theksoi, për zyrtarin policor, për të cilin folëm fjalë lavdëruese, i cili me intervenimin ka shpëtuar shumë jetë, propozoj t'i ndahet një çmim ose dekoratë, në kuadër të kompetencave tua si Kryetar. Për këtë propozim, dua të theksoj pasi që jam përfaqësues i bizneseve të Llapit më shkruajnë shumë biznese lidhur me këtë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ne bashkëpunim me Policinë e Kosovës do ta bëjmë një gjë të tillë, por duhet gjetur momentin e përshtatshëm për këtë çështje.

z.Rozafat Maloku, desha të ndërlidhëm me pjesën që theksoi Drejtori sa i përket barkave. Më duket se më herët e potencuam se ndalohet edhe noti në Liqenin e Batllavës, dhe pasi që noti ndalohet në Liqenin e Batllavës, atëherë çfarë logjike ka që barkat me ekzistua në Liqen. Sikur të lejohet lundrimi me barka atëherë mendoj se si pjesë e sigurisë fillimisht Inspeksioni është dashur ti kontrollojë a janë ato në gjendje të rregullt për lundrim, pastaj me kërkua edhe pjesët e sigurisë që duhet të jenë në ato barka dhe me u jap leje Inspeksioni për të qenë e mundur të nder veprojnë. Më duket pa logjikshme të ndalohet noti ndërsa barkat të lejohen.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, edhe një çështje duhet ta keni parasysh, se zonat e mbrojtura natyrore sikurse kemi të bëjmë me liqenin e Batllavës ku parashihet zona e parë, e dytë dhe e tretë, i menaxhon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ne në nivelin lokal po mundohemi me potencialin tonë për të qenë në shërbim të Ministrisë. Çdo veprim i yni apo vendim i yni si Komunë paraprakisht duhet koordinuar me MMPH sepse ata janë mbikëqyrës dhe menaxhues të zonës së mbrojtur. Por tash a duhet krijuar vakum mbikëqyrjeje në mes nivelit lokal dhe qendror, nëse niveli qendror mund të ketë probleme shumë më të mëdha në kuptim të menaxhimit të tyre. Jemi të gatshëm të marrim përgjegjësitë si Komunë. Ju e dini se kemi pas probleme me ndërtime ilegale dhe është dashur të marrim veprime edhe përkundër që kjo zonë është në kompetencat e MMPH. Mbulueshmërinë në aspektin ligjor e bën MMPH. Atë pjesë Qeveria e ka shpallur Zonë të Mbrojtur dhe veprimet përkatëse realisht i takojnë fillimisht Nivelit Qendror, sepse e ka zonë të vetën të menaxhimit, ndërsa ne si autoritet lokal mundohemi ta ndihmojmë në aspektin e ruajtjes, por përgjegjësia kryesore për zonat e mbrojtura i takon nivelit qendror, sepse kush e shpall zone të mbrojtur i njëjti institucion e monitoron dhe mbikëqyrë hapësirën, fjala është si zona e Liqenit të Batllavës, Bjeshkët e Nemura. Shihni veprimet e Ministrisë në Prevallë që merren, etj, dmth janë zona të mbrojtura që i menaxhon dhe monitoron Ministria. Ne duhet të bashkëpunojmë me ta dhe në kontekst kësaj mund të dërgojë atje ekipet e inspektoriatit, për të kërkuar prej barkave që asnjëra prej tyre nuk mund të lundrojë pa pasur në dispozicion jelekët shpëtues, dhe hipotetikisht po themi pa pasur edhe gomat si pjesë të mjeteve të sigurisë, përndryshe nuk lejohet hyrja në ujë. Çështja tjetër, me çfarë baze legale janë ato varka atje dhe kush duhet ti largojë ato nga aty. Pra duhet larguar nga Ministria sepse ajo e ka nën kontrollë dhe menaxhim si zonë të mbrojtur. Shtrohet pyetja se a mund të bartin atë kompetencë për ti larguar ne, ne mund ti heqim nëse na bartin atë kompetencë. Por është një vakum se kush duhet të veproj dhe kjo krijon dilemën e veprimit se kush duhet të merret me këto veprime. Nëse edhe ju jeni dakord isha dal me një qëndrim prej këtij takimi që së paku për këtë fazë për t'i detyruar ato barka që çdo njëra prej tyre të ketë jelekët shpëtues. Nuk jam në dijeni se a ka pas ndonjë rast tjetër që është mbytur dikush tjetër prej barke, edhe pse jemi në dijeni se aty janë mbytur njerëz gati çdo vit. Është mirë të marrim veprimet për ato çfarë mund ti marrim, barkat me motor mos me i lejuar për të qarkulluar në Liqen. Unë mund të nxjerr një vendim por nuk e di sa jam kompetent, kam dilemat. Ai vendim do të shkonte në dobi të sigurisë dhe kjo nënkupton se nuk është se jam duke bërë farë dëmi.

Për veprimet tjera se ata a duhet të jenë atje apo jo mendoj se duhet koordinuar punët me nivelin qendror. Ata janë qytetarë tonë dhe një pjesë e tyre kanë një benefit aty, ka që dikush siguron të ardhura prej asaj pune gjatë sezonit veror, dhe nëse kjo e ardhur i ndalet edhe kjo punë ka dilema.

Por a kemi të drejtë për të kërkuar masa sigurie, kemi të drejtë sepse mos të bëhet pretekst kjo që ditëve në vijim të na mbyten të tjerë me barkë.
Nëse mendoni, unë mund të dal me një vendim, ma përgatit Zyra Ligjore, ja përcjell inspeksionit dhe e bëjmë një njoftim publik por nuk jam në dijeni se sa mund të legalizojë ato barka sepse nuk është kompetencë e imja.
z. Naim Bajrami, theksoi, para se me marrë këtu një vendim unë kam një propozim që ju Kryetar të bëni një takim në MMPH dhe me i diskutua këto gjëra. Sepse ju i keni trashëguar këto, dhe nuk është problemi i Komunës. Sa kemi të drejtë ne ti ndalojmë ato barka ku ju e theksuat se dikush jeton prej tyre, pastaj edhe restorantet janë poshtë aty buzë Liqenit dhe sa jam unë i informuar lejohen vetëm ato që janë me bateri ose me rrymë. Dhe propozimi tjetër është, a ka mundësi të ndryshohet vendimi i viti 2013 sepse neve na ka shkaktuar shumë probleme, sepse ndryshe vepron Komuna e Prishtinës, nuk ka ndalesa edhe sa i përket ndërtimit në atë pjesë, ndërsa ndryshe është për Komunën e Podujevës, kështu që bëni një takim me të Ministrisë dhe të definohet se çka kemi të drejtë dhe të veprojmë pastaj.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë prapë nuk kisha dalë prej temës së këtij takimi. Tashmë më dërguan bazën ligjore të çështjes për të cilën jemi preokupuar, Ligji nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës i cili parasheh mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm dhe autorizon shpalljen e zonave mbrojtëse dhe të akumulacioneve dhe Udhëzimi Administrativ për zonat sanitare mbrojtëse të burimeve ujore i miratuar nga Qeveria e Kosovës i cili i ndalon aktivitetet që mund të rrezikojnë cilësinë e ujit në zona mbrojtëse, Vendimet e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e Zonave Sanitare Mbrojtëse të Liqenit të Batllavës, Badovcit të cilat zbatohen nga KRU Prishtina. Këto vendime ndalojnë aktivitet si notin, peshkimin e paautorizuar, lundrimin me mjete lundruese pa leje dhe çdo aktivitet që mund të ndikoj në cilësinë e ujit të pijshëm, pra të gjitha janë të ndaluara, dhe vetëm me leje të veçantë lejohen. Realisht të gjitha këto veprimtari janë të ndaluara. Tash ne duhet drejtuar me një shkresë MMPH që të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse që ju takojnë në bazë legjislacionit në fuqi, apo të na bartin ndonjë kompetencë që të merremi ne nivelet lokale me këtë çështje. Unë pas këtij takimi do tu bëjë një shkresë zyrtare MMPH dhe do tua paraqes këto probleme dhe shqetësimet tonat dhe do të kërkoj për të bashkëpunuar, si për të vepruar tutje lidhur me këtë.
Nëse nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar, edhe njëherë në mbyllje të këtij takimi dhëntë Zoti që raste të tilla të mos kemi në të ardhmen, por edhe nëse ndodhin të jenë sa më të pakta dhe e dyta po shpreh falënderimin tim publikisht për veprimet e shpejta që janë ndërmarrë edhe nga Forcat e Sigurisë së Kosovës për rastin e Liqenit të Batllavës, zyrtarëve të Policisë së Kosovës për incidentin e ditës së djeshme, urgjencën e qytetit dhe të gjithë akterët që janë të përfshirë në rast. Dje mendoj se kanë treguar një shembull se si kryhet puna me kompetencë të lartë. Veprimet në veçanti të zyrtarit policor mendoj se kanë parandaluar një rast me pasoja shumë më të mëdha, prandaj unë shpreh falënderim të gjithëve , edhe ju ftoj se bashkëpunimi mes institucioneve tona të jetë sa më i ngushtë dhe në çdo gjë që mendojmë që kemi lëshime, apo ndonjë çështje që punët mos të na rrjedhin si duhet, ne ofrojmë bashkëpunim dhe kemi gatishmëri për bashkëpunim.
Ne si institucione lokale do i marrim të gjitha veprimet, ato që hyjnë në fushën apo domenin tonë të sigurisë, të jenë në bashkëveprim të ngushtë me të gjitha instancat e sigurisë, çoftë të nivelit lokal, qoftë të nivelit qendror, në mënyrë që të parandalojmë dhe mos të kemi situata të tilla.
Ju falënderoj shumë të gjithëve për kontributin. Mirupafshim në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11.25
Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. prot. 02-060/04-0038785/26
Podujevë, datë: 03.07.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi